

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Arbitrazhi rrezon kërkesat e VIA-s", MIE: Hyn në fuqi zgjidhja e kontratës për Aeroportin e Vlorës - Euro news Albania
ADRESA	https://euronews.al/arbitrazhi-rrezon-kerkesat-e-via-s-mie-hyn-ne-fuqi-zgjidhja-e-kontra-tes-per-aeroportin-e-vlores/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 16:02:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 15:43:41 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b880d442ca14436f77e3130373eec5f3305b01fe8c26da00fa8d8ba9d8c9b8ed
TEKSTI	2d02cebe2e851ba87b7eb152d4548ad83a2a5d360dc23d1aa6d07c2e0735e031
PAMJA	4cd7178b18ea2d407b5d5c8c4ebd7da28de34908dad6c6a0fefdf7c969798c5d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4a5c17b1102e0e9fc65883e0f399fa6d8b9e836dd505c7f1bb97611dde56c852
E MËPARSHMJA	28af1b9f2e04794e0413cd355973d786a2c9cad465ed9fd8eec463f17b9a5f9b
RRËNJA MERKLE	565d15129a3a8f2c33135848c08d2b7db1d78c2d7a3d3b93f84b73cbde96b20f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4a5c17b1102e0e9fc65883e0f399fa6d8b9e836dd505c7f1bb97611dde56c852>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Gjyqi i UÇK Protesta në Tiranë Kuvendi i Shqipërisë Milan Tërmet

EKONOMI | LAJMI I FUNDIT

“Arbitrazhi rrëzon kërkesat e VIA-s”, MIE: Hyn në fuqi zgjidhja e kontratës për Aeroportin e Vlorës

17 Shtator 2026 | 17:43

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka njoftuar se Arbitrazhi i Emergjencës ka rrëzuar kërkesat kryesore të VIA-s, koncesionarit të Aeroportit të Vlorës, dhe nuk ka pranuar të pezullojë zgjidhjen e Kontratës së Koncesionit.

Sipas njoftimit për media të kësaj ministrie, më 16 shtator 2026, Arbitri i Emergjencës nxori Urdhrin në kuadër të procedurave të arbitrazhit të urgjencës të nisura nga VIA dhe “rrëzoi tërësisht dy nga tri kërkesat e VIA-s” ndërsa nuk pranoi kërkesën kryesore të kompanisë për pezullimin e zgjidhjes së Kontratës së Koncesionit.

Ministria sqaron se e vetmja masë e urdhëruar ishte “ruajtja e kufizuar dhe e përkohshme e status quo-së”, deri në konstituimin e tribunalit të arbitrazhit dhe momentin kur ai të jetë në gjendje ta shqyrtojë çështjen.

“Arbitri rrëzoi kërkesën e VIA-s për të pezulluar si zgjidhjen e Kontratës së Koncesionit, ashtu edhe zbatimin e Njoftimit për Zgjidhje. MIE thotë se Arbitri ra dakord me qëndrimin e saj se “as Kontrata, as provat e paraqitura nuk ofronin bazë të mjaftueshme ligjore” për një masë të tillë. Si rrjedhojë, zgjidhja e Kontratës së Koncesionit ka hyrë në fuqi”, thuhet në njoftimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ministria sqaron gjithashtu se, sipas vendimit të Arbitrit të Emergjencës, janë rrëzuar edhe kërkesat e VIA-s që MIE të detyrohej të merrte pjesë në ndërmjetësim dhe të caktonte një ndërmjetës, si dhe kërkesa për shtyrjen e fillimit të arbitrazhit me dy muaj të tjerë.

“Rrëzimi i këtyre kërkesave bën që mosmarrëveshja të mund të kalojë menjëherë te tribunal i arbitrazhit, ku ministria thotë se “do të vazhdojë të mbrojë me vendosmëri qëndrimin e saj”. Për masën e përkohshme, Arbitri i Emergjencës ka urdhëruar që, përkohësisht, ministria të mos ushtrojë të drejta të caktuara që lindin pas zgjidhjes së Kontratës së Koncesionit. Kjo masë është afatshkurtër dhe do të mbetet në fuqi vetëm deri në konstituimin e tribunalit të arbitrazhit dhe derisa ai të jetë në gjendje ta shqyrtojë çështjen. Kjo masë “nuk cenon vlefshmërinë apo efektshmërinë e zgjidhjes së Kontratës së Koncesionit”, thuhet në njoftim.

Sipas njoftimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Arbitri i Emergjencës ka urdhëruar gjithashtu VIA-n të përballojë shpenzimet e procedurave të arbitrazhit të urgjencës.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e cilëson vendimin si “një dështim të qartë të VIA-s për të siguruar vendimin në përputhje me kërkesat e saj”

LAJMI I FUNDIT

18:20 Milan në krizë, Cardinale telefonon Amorimin

18:17 Një tërmet i fortë godet Alaskën, sa ishte magnituda

18:10 Thaçi reagon pas vendimit në Hagë: Mohoj çdo përfshirje në vrasje, do ta apeloj vendimin

18:06 Gjopa dhe pezullime në SHPËRNDARJE!
futbollin shqiptar, 6 klubeve u ARTIKULLIN!
bllokohet merkatoja

17:47 Kombëtarja nis përgatitjet për Nations League, Maran shpall të shtunën listën e kuqezinjve

17:30 Kurti pret Hamzën pas vendimit të Hagës, diskutojnë apelinin e aktgjykimit

TESTIM

“VIA kishte kërkuar të pengonte hyrjen në fuqi të zgjidhjes së Kontratës së Koncesionit dhe të vononte fillimin e arbitrazhit përmes një procesi të zgjatur ndërmjetësimi. “Nuk arriti asnjëherë prej tyre”. Vendimi i mundëson të përgatisë hapat e mëtejshëm që rrjedhin nga zgjidhja e Kontratës së Koncesionit, të cilët, sipas ministrisë, janë të nevojshëm “për të mbrojtur interesin publik”, duke respektuar masën e kufizuar dhe afatshkurtër të urdhëruar në pritje të konstituimit të tribunalit të arbitrazhit”, njofton ministria.

Në përputhje me vendimin e Arbitrit të Emergjencës, MIE ka bërë të ditur se do ta njoftojë VIA-n se “zgjidhja e Kontratës së Koncesionit ka hyrë në fuqi”.

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

EKONOMI | SOCIALE | VENDI

ABI Bank konsolidon rritjen në gjashtëmujorin e parë 2026

Zgjerimi i shpejtë i rrjetit të degëve, likuiditeti i lartë dhe forcimi i kapitalit dëshmojnë zhvillimin e qëndrueshëm të Bankës. Banka Amerikane e Investimeve ka...

16:27 | 16/09/2026

EKONOMI

Prestigjiozja evropiane Euractiv vë në fokus bankingun digjital shqiptar

Zhvillimet në sektorin financiar shqiptar janë bërë pjesë e analizës së medias evropiane Euractiv, e cila ka ndalur te transformimi digjital i bankingut dhe potenciali...

12:47 | 16/09/2026

EKONOMI

Nisin punimet për Bypass-in e Elbasanit, Karakaçi: I japim zgjidhje trafikut

Kanë nisur punimet për ndërtimin e Bypass-it të Elbasanit, një projekt që synon të lehtësojë trafikun në qytet dhe të krijojë një lidhje më të...

19:06 | 15/09/2026

TEMA	SHËRBIME	KOMPANIA
Vendi	Live	Rreth Euronews
Rajoni	Lajmi fundit	Kushtet e përdorimit
Bota	Na ndiqni	Politika e cookie
Video	Euronews Radio	Kontakttoni
	Për persona me aftësi të kufizuara	Punësimi

Follow Euronews on all platforms: